



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:292826

Datë: 29.03.2024

Numri i dokumentit: 05524359

P.nr.1373/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Marigona Lajqi, me bashkëpunëtoren profesionale Medina Rama, në çështjen penale ndaj të akuzuarit V. J., për shkak të veprës penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë- Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.3932/19 e datës 17.12.2019, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar me datë 11.03.2024, në prezencë të Prokurorit të Shtetit Ajtene Zoni, si dhe të akuzuarit V. J. dhe mbrojtëses së tij sipas detyrës zyrtare av. Hidajete Mazhiqi, me datë 12.03.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 27.03.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

V. J., nga i ati B., e ëma M., e vajzërisë O., i lindur me datë ... në Vushtrri, tani me vendbanim në Mitrovicë në rrugën “...” ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datë 24.10.2019 rreth orës 20:00 në Mitrovicë, në rrugën “...” pa autorizim ka poseduar substancë narkotike, në atë mënyrë që gjatë kontrollit nga policia është kapur se me veti, në trupin e tij kishte një (1) qese me substancë të dyshuar narkotike, ku në të njëjtën është

konfirmuar prania e kanabisit (marijuanës) e cila përmbante Tetrahidrokanabinol (THC) në peshë prej $0,94 \pm 0.0001$ gr., e cila është marrë nga ai.

Me këtë ka kryer veprën penale: Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në bazë të neneve: 1, 4, 7, 17, 21, 38, 40, 42, 43, 69, 70, 71, 72 lidhur me nenin 269 par. 1 të KPRK-së dhe neneve 364, 449, 452 të KPP-së, të akuzuarit, i:

S H Q I P T O N

- I. Dënim me burgim në kohëzgjatje prej katër (4) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 30 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II. Dënim me gjobë në shumë prej dyqind (200) euro, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar ta paguajë në afat prej 30 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i akuzuari nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, Gjykata do të veprojë në bazë të nenit 43 par.3 të KPK-së, ashtu që të njëjtit dënim me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim me burgim duke llogaritur për çdo 20 € (euro) gjobë me një (1) ditë burgim.
- III. I akuzuari obligohet që në emër të shpenzimeve procedurale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej tridhjetë (30) euro, në emër të fondit të kompensimit të viktimave të krimit shumën prej njëzet (20) euro, të gjitha këto në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- IV. Në mbështetje të nenit 269 par.3 të KPRK-së e lidhur me nenin 276 par.2 nën par.2.2 të KPP-së, URDHËROHET konfiskimi i përhershëm i substancës narkotike Tetrahidrokanabinol (THC) në peshë prej $0,94 \pm 0.0001$ gr.
- V. Kërkesë pasurore juridike nuk pati.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Mitrovicë- Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.3932/19 e datës 17.12.2019 ndaj të akuzuarit V. J., për shkak të veprës penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 11.03.2024, në të cilën kanë prezantuar Prokurori i Shtetit Ajtene Zoni, si dhe i akuzuari V. J. dhe mbrojtësja e tij sipas detyrës zyrtare av. Hidajete Mazhiqi

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit, të akuzuarit i është dhënë mundësia që të deklarohet lidhur me fajësinë, ashtu që në këtë seancë i akuzuari lidhur me pranimin e fajësisë ka deklaruar se e pranoj fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohem.

Prokurori i Shtetit Ajtene Zoni lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se i propozoj gjykatës që t'ia pranoj pranimin e fajësisë të pandehurit, ngase pranimi i fajësisë është dhënë në mënyrë vullnetare, konform dispozitave ligjore të nenit 242 të KPP-së, pranimi i fajësisë ka mbështetje në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe gjendjes faktike.

Mbrojtësja e të pandehurit V. J., av Hidajete Mazhiqi lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se kërkoj nga gjykata që të bëj pranimin e fajësisë pasi që i njëjti është bërë në mënyrë vullnetare pa presion nga ana e të pandehurit.

Gjykata ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit mbështetet në provat të cilat i disponon kjo gjykatë si Raporti fillestar i incidentit me numër të rastit 2019-DHTN-767 i datës 24.10.2019, vërtetimi mbi konfiskimin e pasurisë i datës 24.10.2019, Shënimi zyrtar nga Drejtoria për hetimin e trafikimit me narkotik DHTN- Mitrovicë e Jugut, i datës 24.10.2019, Procesverbali i marrjes në pyetje për të dyshuarin V. J., i datës 24.10.2019, Raporti i Ekspertimit, i datës 11.11.2019, si dhe foto dokumentacioni dhe shkresat e tjera të lëndës. Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë të këtyre provave

dhe pranimit të fajësisë, konsiderojmë se përtej çdo dyshimi është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale që i vihet në barrë.

Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në mënyrë vullnetare, dhe pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësen e tij, se i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, duke i' u tërhequr vërejtja të akuzuarit se pas pranimit të fajësisë, ai nuk mund të bëjë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, por vetëm sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga i akuzuari.

Prokurori i shtetit lidhur me rrethanat e matjes së dënimit ka deklaruar se i propozoj gjykatës që me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit konform nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, të merren parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara sipas Kodit dhe si rrethanë rënduese të meret fakti se vepra penale është kryer me dashje, ndërsa si rrethanë lehtësuese të merret pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit.

Mbrojtësja e të pandehurit av. Hidajete Mazhiqi lidhur me rrethanat e matjes së dënimit ka deklaruar se pasi që i mbrojturi im pranimin e fajësisë e ka bërë në mënyrë vullnetare, i propozojmë gjykatës që të marr parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese pasi që i njëjti është i penduar për veprën penale, i ka premtuar gjykatës se nuk do të veprojnë në kundërshtim me ligjin dhe duke pasur parasysh gjendjen e dobët ekonomike të familjes ka kërkuar nga gjykata që të njëjtit ti shqiptohet një dënim sa më i butë.

I pandehuri ka deklaruar se e mbështes fjalën e mbrojtësit tim dhe nuk kam asgjë tjetër për të shtuar.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë së të akuzuarit dhe nga provat e cekura si më lart, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i akuzuari V. J. ka kryer veprën penale: Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-së e për të cilën veprë është paraparë dënimin me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 dhe 70 të KPRK-ës.

Gjykata, si rrethanë lehtësuese ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale nga i akuzuari në seancën e shqyrtimit fillestar, gjendjen e dobwt ekonomike, moshwn e re tw tw akuzuarit. Ndërsa, si rrethana rënduese, gjeti mënyrën e kryerjes së veprës penale, dashjen e kryesit në kryerjen e veprave penale, si dhe rrezikshmërinë e këtyre veprave penale si dhe faktin se sipas verifikimeve të kësaj gjykate i njëjti rezulton të jetë i dënuar me dy aktgjykime të plotëfuqishme për vepra të ngjajshme penale. Me Aktgjykimin P.nr.129/2019 i plotëfuqishëm me datën 28.03.2022, i njëjti është dënuar për shkak të veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 267 par.1 të KPRK-së, si dhe me Aktgjykimin P.nr.65/2019 i plotëfuqishëm me datën 06.11.2023, i akuzuari V. J. është dënuar për shkak të veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 273 par.1 të KPRK-së.

Nga verifikimi mbi të kaluarën penale i bërë nga kjo gjykatë, gjithashtu rezulton se i akuzuari ka qenë i dënuar me Aktgjykimin P.nr.828/19, i plotëfuqishëm me datën 04.09.2020 po ashtu për veprën penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 të KPRK-së, si dhe me Aktgjykimin PKR.nr.35/20 për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 i KPRK-së, mirëpo këto dënime figuron si të shlyera, andaj gjykata nuk i mori për bazë si rrethanë rënduese me rastin e matjes së dënimit.

Me rastin e caktimit të dënimit, gjykata ka aplikuar dispozitat e zbutjes së dënimit, duke qenë se i akuzuari e ka pranuar fajësinë dhe në kuptim të nenit 71 par.1, nën par 1.3 të KPRK-së, kjo është rrethanë ligjore për zbutjen e dënimit. Megjithatë, me rastin e zbutjes së dënimit janë respektuar kufijtë e zbutjes në kuptim të nenit 72 par. 1 nën par. 1.5 të KPRK-së.

Gjykata vlerëson se dënimi i shqiptuar si në dispozitivin e aktgjykimit, është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit. Poashtu gjykata vlerëson se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit, i cili parashihet me nenin 38 të KPRK-së, që të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, duke vlerësuar se i akuzuari do të përmbahet nga veprimet e paligjshme në të ardhmen.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata e mori në kuptim të nenit 449 par 2 nën par 2.1 dhe 2.6 dhe nenit 452 të KPP-së. Ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 36 par. 3 nën. par 3.1 të Ligjit nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Kërkesë pasurore juridike nuk pati, ngase sipas aktakuzës nuk kishte të propozuar palë të dëmtuar.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 364 dhe 452 të KPPK-ës, nga arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni penal

P.nr.1373/2019, datë 27.03.2024

Gjyqtarja e vetme gjykuese

Marigona Lajqi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh prej ditës së pranimit të këtij aktgjykimi përmes kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.